



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI I BASHKISË**

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2025

MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK - NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % DHE NGA FONDET E DREJTORISË SË SHËRBIMIT SOCIAL.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____. _____.2025, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 8/2, 9 pika 1.1, gërma “b”, 21, 64 gërma “c”, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021, kreu IV, pika 1, 2 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe VKM nr.8 datë 14.01.2015 i ndryshuar në datë 15.01.2019 “Për mbrojtjen e Shtresave në Nevojë, për efekt të heqjes së Fashës së Kompesimit të Energjisë Elektrike deri në 300 kwh në muaj”. VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

V E N D O S I:

- I. Miratimin e kritereve për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 % dhe nga fondet e drejtorisë së shërbimit social si më poshtë:
 1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
 2. Familje me kryefamiljare gra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
 3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune.

- 6
4. Familjet ose individët që kanë një pension të ulët.
 5. Familje me shumë fëmijë.
 6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë që ndjekin arsimin bazë dhe universitar.
 7. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftesi/invalide pune.
 8. Familje që kanë një anëtar dhe janë të braktisur ose të vetmuar.
 9. Familjet të rikthyera nga emigracioni ose azil kërkuese që i përkasin komunitetit rom/egjiptian dhe mazhorancë.
 10. Familje shumë të varfëra që për arsyeje të ndryshme nuk arrijnë të aplikojnë sipas ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, këto familje do të trajtohen nga fondet e buxhetit vendorë duke vijuar si më poshtë :

- I. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597 datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
- II. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 597 date 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
- III. Dokumentat e aplikuesve për piken 10 janë : Certificate familjare, fotokopjen e kartës së identitetit, vërtetim nga Njësia Administrative (vërtetim vendbanimi) ose SPZ e zonës ku banon, dokumenta të ndryshem nga institucionet shëndetësore dhe institucione të tjera vendore ose lokale, verifikime në sistemin e-albania çdo 3 (tre)-muaj dhe formularin e paraqitjes mujore Mod 2, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin Ceca

Këshilli i Bashkisë e miratoi me : ___ Vota Pro, ___ Vota Kundër, ___ Vota Abstenim

Adresa: Blvd. “Republika 2”, Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935, website: www.bashkiaberat.gov.al, Email :

bashkiaberat@yahoo.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2025

MBI MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE PËRFUNDIMTARE SË BASHKU ME VLERAT PERKATËSE TË PREVENTIVIT TË FAMILJEVE PËRFITUESE, PËR PROJEKTIN "PËRMIRËSIM I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA, VITI 2025".

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 9, pika 1.1, neni 24, neni 54, neni 64 gërma "c"; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", VKM nr. 454, datë 3.7.2019 "Për procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", VKM nr. 458, datë 3.7.2019, VKM nr.216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimi e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim", termave të referencës "Për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2025-2026 sipas shkresës së M.E.K.I. me nr.15900, datë 18.12.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1. Të miratoj, listën emërore përfundimtare së bashku me vlerat perkatëse të preventivit të familjeve përfituese, për projektin "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara, viti 2025", përbërë nga 48 familje.

Bashkëlidhur projekt-vendimit lista përfituese .

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave, Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve .

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2025

MBI MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIMIN E BASHKISË NË PROJEKTIN “PËRMIRËSIM I KUSHTEVE TE BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, VKM nr. 454, datë 3.7.2019 “ Për procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese” , VKM nr. 458, datë 3.7.2019, VKM nr.216, dt 13.4.2023, shkresës së M.E.K.I me nr.15900, datë 18.12.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

- 1.Të miratoj , deklaratën për bashkëfinancimin e bashkisë Berat në projektin “ Përmirësim i kushteve te banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara“, për vitin 2025 në masën 30 % të koston totale të projektit.
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave ,Transportit dhe Shërbimeve .

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2025

MBI MIRATIMIN E QIRASË MESATARE MUJORE TË BANESAVE NË TREGUN E LIRË

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, ”Për strehimin social”, pikën 6 të VKM nr.459, datë 3.07.2019, “Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin” ,

V E N D O S I :

1. Miratimn e nivelit të qirase mesatare mujore të banesave në tregun e lirë sipas strukturës së apartamentit , si më poshtë:

1.Për Lagjjen Nr.1 dhe Nr.3

- Për apartamentin me strukturë 1+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 15 000 lekë.
- Për apartamentin me strukturë 2+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 20 000 lekë.

2.Për Lagjjen Nr.2

- Për apartamentin me strukturë 1+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 17 000 lekë.
- Për apartamentin me strukturë 2+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 22 000 lekë.
- Për strukturën garsoniere nuk kemi të dhëna në tregun e lire, pasi banesa me këtë strukture, janë në një numër të papërfillshëm .

2.Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile Sherbimeve, Transportit dhe Pronave .

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2025

MBI MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QE PËRFITOJNË BONUS QIRAJE

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, ”Për strehimin social”, pikën 6 të VKM nr.459, datë 3.07.2019, “Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”,shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr.15900 prot,dt 18.12.2024 “Mbi fondet për programet e strehimit 2025 ”

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës për 50 familje të pastreha që përfitojnë bonus qiraje për vitin 2025, sipas tabelës bashkëlidhur këtij projektvendimi .
2. Vlera e bonusit të qirasë do të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe nga buxheti i bashkisë dhe do të filloj për çdo familje sipas afatit të kontratës së qirase .
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi , ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , si dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile , Pronave,Transportit dhe Shërbimeve.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2025

PËR NJË SHITESË NË VKB NR.105 DATË 18/ 12 /2024 , “MBI MIRATIMIN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN ARSIMOR 2024-2025”

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, Bashkia Berat, mbështetur në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 9, neni 64, gërma “c”, VKM nr.666, datë 10.10.2019 te ndryshuar VKM nr.511, datë .27.7.2022 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të vecanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”

PROPOZON:

I.Në VKB nr.105 datë 18.12.2024 “Mbi miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin arsimor 2024-2025”, të shtohet pika 1.2 me këtë përmbajtje:

Miratimin e bursës së plotë për nxënësit:

- 1- Anxhelo Xhevair Sakaj shkolla e mesme profesionale “Stiliano Bandilli”, në klasën e XI-të , pasi plotësonë kriteret për të përfituar bursë të plotë.
- 2- Sara Syrja Sinaraku, nxënëse në shkollën e mesme profesionale “Stiliano Bandilli”, klasa e XI-të, pasi plotësojnë kriteret për të përfituar bursë të plotë.
- 3- Ujgen Aleksander Lilaj shkolla e mesme profesionale “Stiliano Bandilli”, në klasën e X-të, pasi plotësonë kriteret për të përfituar bursë të plotë.
- 4- Sabiela Klodian Vrapit shkolla e mesme përgjithshme “Kristaq Capo”, në klasën e XI-të, pasi plotësonë kriteret për të përfituar bursë të plotë.
- 5- Merlina Taulant Plaku shkolla 9-vjecare “28 Nëntori” kriteri ekonomik 2.1 c “Nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk e ndjekin arsimin bazë”.
- 6- Tana Naun Sylari shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”, në klasën e X-të, pasi plotësonë kriteret për të përfituar bursë të plotë.
- 7- Azbi Nexhip Shkurti shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”, në klasën e X-të, pasi plotësonë kriteret për të përfituar bursë të plotë.
- 8- Klea Ermir Mjeshtri shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”, në klasën e X-të, pasi plotësonë kriteret për të përfituar bursë të plotë.
- 9- Arsen Verlind Troka shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”, në klasën e X-të, pasi plotësonë kriteret për të përfituar bursë të plotë.
- 10- Vesjana Ilirjan Hysa shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”, në klasën e X-të, pasi plotësonë kriteret për të përfituar bursë të plotë.
- 11- Pietro Luciano Boce shkolla e mesme e përgjithshme “Babë Dudë Karbunara ”, në klasën e X-të, pasi plotësonë kriteret për të përfituar bursë të plotë.

II.Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit e Bashkisë Berat.

KRYETAR
Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI I BASHKISË**

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2025

**MBI MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027
BASHKIA BERAT**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës ____ . ____ .2025, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 75/ 2019 “Për Rininë”, “Strategjisë Kombëtare e Rinisë 2022-2029”,

V E N D O S I:

- I. Miratimin e Planit Lokal të Veprimit të Rinisë 2025-2027, Bashkia Berat.
- II. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin Ceca